

Takimi i 5-të i Grupit të Përshërshëm të Nivelit të Lartë (GPNL)

DRAFT KONKLuzionet Mali i Zi, 28 Qershor 2007

- (1) GPNL-së iu është prezantuar draft raporti i përpiluar nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE) mbi Implementimin e Traktatit dhe aprovimit të tij.
- (2) GPNL-ja përmes UNMIK-ut është informuar rreth vazhdimësisë së diskutimeve lidhur me operimin e mekanizmit kompesues Inter TSO (OST) në mes të UNMIK-të dhe TSO-së (OST) së Serbisë. Komisioni ka shprehur gatishmërinë e vet për të ndërmarr disa konsultime teknike dhe të caktojë një ekspert të pavarur për të vlerësuar aspektet e mekanizmit ITC. Raporti statusor për diskutim do të prezantohet në takimet e ardhshme të GPNL-së dhe SETSO TF.
- (3) GPNL-ja ka falënderuar Drejtorin lidhur me Raportin Gojor mbi Implementimin e Programit Punues (2007), të adoptuar në vitin 2006 në takimin Ministror në Shkup.
- (4) GPNL-ja ka aprovuar dhe vendosur që Raportin e Parë Vjetor¹ ta pason matej në Aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të Këshillit Ministror për adoptim formal.
- (5) Prezantimi i shënimeve të GPNL-së në të cilën paraqiten plotësimet e kërkesave të Nenit 20, dhe 29, mbi burimet ripërtëritëse dhe sigurinë e furnizimit. Vendet/Palët Kontraktuese që nuk kanë dorëzuar deklaratat e tyre deri tani janë të ftuar ta bëjnë këtë deri në mes të muajit Korrik 2007.
- (6) GPNL-ja ka rekomanduar në Këshillin Ministror që Maribori të zgjidhet si vend për mbajtjen e Forumit për Gaz.
- (7) Eficienca e Energjisë: Për sa i përket Nenit 35 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, GPNL-ja pajtohet në krijimin e Task-Forcës (Grupit Veprues)

¹ Përfaqësuesi i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ka shprehur rezervimet e lidhur me përdorimin e referencës në vend të emrit kushtetor të vendit e cila është Republika e Maqedonisë

për të paraqitur planin detaj për të mbuluar çështjet e efijencës së energjisë të Vendeve/Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Këtë Task-Forcë mund ta shoqërojnë Vëzhguesit si pjesëmarrës aktiv. GPLN-ja ka kërkuar nga Sekretariati të bëjë propozim mbi kompozimin dhe punën e Task Forcës.

- (8) Lidhur me Memorandumin Social, GPLN-ja është pajtuar që Këshilli Ministror do të pajtohet lidhur me substancën e këtij Memorandumi. Më vonë do të jetë e hapur për nënshkrim që nga Tetori 2007, mundësisht përmes organizimit të një Konference mbi çështjet sociale. Komisioni ka informuar që ajo është e gatshme të nënshkruaj në emër të Komunitetit Evropian.
- (9) GPLN-ja është pajtuar që Sekretariati të paraqes një dokument me opsione për krijimin e forumit i cili do të jetë përgjegjës për adresimin e çështjeve sociale.
- (10) GPLN-ja ka rekomanduar Këshillit Ministror që draft Agjenda e Këshillit Ministror dhe Draft Konkluzionet e Këshillit Ministror (përfshirë Shtojcën) të adoptohen.
- (11) GPLN-ja ka aprovuar përpjekjet lidhur me procedimin efikas të rekrutimit brenda Sekretariatit. Lidhur me këtë është marr shënim që kontratat e stafit do të përfshihen në një shtojcë me kopje të tekstit të draftit. Rregulloret e Stafit me referencë eksplicite, ku kjo shtojcë do të jetë valide deri në datën e hyrjes në fuqi të Rregullores së Stafit adoptuar nga Këshilli Ministror. Pas kësaj date, Rregulloret e Stafit do të vlejnjë.
- (12) Komisioni ka ngritur pyetjen lidhur me afatin kohor për përgatitjen e takimit të Këshillit Ministror. GPLN-ja është pajtuar që të analizojë mundësit e siguruara nga Rregullat Interne të Procedurës së Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë (Akti Procedural Nr 2006/01) për të përmirësuar kohën e përgatitjes së takimeve.

Këto konkludime janë adoptuar.

Për Grupin e përhershëm të Nivelit të Lartë,

PRESIDENCA